



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR ELBASAN
NR.REGJ.THEM. 1154 (61012-03240-13) NR. VENDIMIT 1154 (13-2014-5798)
Date 02.10.2014 Date 02.10.2014

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan, me trup gjykues te perbere nga:

Gjyqtar *TOMORR KULLOLLI*

Asistuar prej sekretares Klodiana Ullorja mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore me dt. 02.10.2014, kerkesen e paraqitur nga :

KERKUES : Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan, perfaqesuar nga prokuroria Enkeleda Millonai.

OBJEKTI I KERKESES : Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive të llogarive bankare

BAZA LIGJORE : Neni 274 i K.Pr .Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi kerkesen e prokurores dhe provat bashkengjitur kerkeses, qe ne perfundim kerkoi pranimin e kerkeses ;

V E R E N

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimi penal nr.2412, viti 2014, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të personit nën hetim Kastrot Duka.

Rezulton se shërbimet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan kanë administruar informacion në rrugë zyrtare dhe ligjore nga një organ qëndror se një person i identifikuar me emrin Kastriot Duka, i datëlindjes 1969, lindur e banues në Elbasan, ka shoqata dhe shoqëri nen perfaqesimin e tij te cilat dyshohet se jane ne te vertete mbulime te aktiviteve kriminale.

Konkretisht rezulton se ky shtetas:

- Është përfaqësues i shoqatës (OJF) “RAHMA MERCY” Nipt L036013910, e cila sponsorizohet nga shoqata “RAHMA/ MERCY” me qendër në Britaninë e Madhe.
- Në datë 19/11/2013 ka regjistruar shoqërinë “RAHMA SCHOOL” shpk me NIPT L33519201M, selia: Lgj. “Visarion Xhuvani”, Rr. “7 Marsi”, Elbasan, me objekt “Hapje të qendrave të edukimit shëndetësor, institucione arsimore si: kopshte, shkolla; Në fushën e kujdesit social. Të botojë gazeta, revista, libra, si dhe të ushtrojë aktivitetin e saj nëpërmjet medias.”

Në periudhën 2010-2014 ka realizuar veprime bankare në Bankën Procredit si më poshtë:

tington Road
shumën

të dhëna për radikalizëm fetar, idoktrinim dhe nxitje për pjesëmarrje në luftën në Siri, lindin dyshime mbi aktivitetin e shtetasit Kastriot Mersin Duka, dhe Arben Ramka i cili i ka të gjitha mundësitë financiare për shkak të abuzimit me fondet e OJF për të mbështetur veprimtarinë e tij radikaliste brenda dhe jashtë vendit. Ndodhur në këto kushte, vlerësohet se ekziston një dyshim i arsyeshëm i mbështetur mbi prova dhe indicie se nga ky shtetas, është konsumuar vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Sa më sipër si dhe në tërësinë e veprimeve hetimore të deritanishëm organi prokurorise vlerëson se është e nevojshme vendosja e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi llogaritë bankare që mund të disponoje shtetasi Kastriot Duka pranë Bankave të Nivelit të Dyte në Republikën e Shqipërisë, si me poshte vijojne; Banka Intesa San Paolo; Banka Raiffeisen; Banka Kombetare Tregtare; Banka Nderkombetare Tregtare; Banka Procredit; Banka e Bashkuar e Shqipërisë; Banka Tirana; Banka Alpha Bank; Banka Kombetare e Greqisë; Banka Credit Agricole; Banka e Pare e Investimeve në Shqipëri; Banka Credins; Banka e Kreditit të Shqipërisë; Banka Societe General Albania; Banka Veneto; Union Bank.

Vendosja e kësaj mase sipas prokurorise është e nevojshme pasi lënia e lirë e transaksioneve mbi këto llogari bankare krijon mundësinë e tjetërsimit, ndryshimit dhe fshehjes së këtyre llogarive bankare dhe të shumave të parave në to si dhe krijon mundësinë e kryerjes së zgjatjes dhe rëndimit të pasojave të veprës penale.

Neni 274 i K.Pr.Penale nder te tjera parashikon

- 1- *"Kur ka rrezik që disponimi i lire i nje sendi që lidhet me veprën penale mund të rendojë ose të zgjase pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2....."*

Sa me sipër Gjykata çmon se kërkesa e prokurorise se Rrethit Gjyqësor Elbasan është e drejte dhe e bazuar në ligj, neni 274 /1 të K.Pr.Penale dhe si e tillë duhet pranuar, me qëllim kryerjen e një hetimi të plote e të gjithanshem të kesaj çështjeje, pasi kemi të bëjmë me një veprë penale me rrezikshmeri të lartë shoqërore, pasi shtetasi mesipër dyshohet për kryerjen e një veprë penale që demton interesat jo vetëm të shtetit dhe shtetasve shqiptarë por dhe shtetasve të tjerë që kanë të bëjnë me luftën kundër terrorizmit në mbare botën, dhe faktin se ky shtetas ka menaxhuar shuma të mëdha në këto banka.

PER KETO ASRYE

Gjykata, bazuar në nenin 274 të K.PR.Penale.

V E N D O S I

Pranimin e kërkesës së Prokurorise Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive të llogarive bankare në emer të shtetasit Kastriot Duka, i biri Mersinit i datelindjes 26.06.1969, në Bankat e Nivelit të Dyte si me poshte vijon:

- Banka Intesa San Paolo;
- Banka Raiffeisen;
- Banka Kombetare Tregtare;
- Banka Nderkombetare Tregtare;